


## RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KAÇANIK

PROJEKTET E MONITORUARA  
“NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË LOKACIONET KAÇANIK,  
BEGRACË DHE KOVAÇEC”  
“NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I TEREENEVE SPORTIVE NË BASHKËSITË LOKALE  
DOGANAJ - SOPONICË DURAJ”





*Nëntor 2025*

*Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo. Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.*

## **RAPORTI I EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KAÇANIK**

PROJEKTET E MONITORUARA

**“NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË LOKACIONET KAÇANIK,  
BEGRACË DHE KOVAÇEC”**

**“NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I TERENEVE SPORTIVE NË BASHKËSITË LOKALE  
DOGANAJ - SOPONICË DURAJ”**



## **DEMOS** Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Qeveria Zvicerane dhe Qeveria Suedeze dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë. Mbështetja e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës Komunale si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar. Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Projekti i DEMOS ka mbështetur edhe ndërtimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që përfshijnë qytetarët në vendimarrje duke përfshirë ekipet e Auditimit Social të cilat kanë mbikëqyrur implementimin e projekteve të cilat janë financuar nga Granti i Performancës.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë.

Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova në partneritet me Demokraci Plus është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e Auditimit Social në 16 projektet e përgjedhura në gjashtë komuna, Drenas, Lipjan, Istog, Dragash, Kaçanik dhe Mamushë.

Demokraci Plus (D+) është organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. D+ tenton integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet e tyre, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie. D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore. D+ ndërmerr iniciativa që kanë për qëllim afrimin e vendimmarrësve më afër qytetarëve përmes hulumtimeve të politikave, lehtësimit të dialogut apo komunikimit dhe edukimit publik.

Handikos Kaçanik është organizatë joqeveritare e decentralizuar që nga viti 2016 nga Handikos. Organizata numëron rreth 400 anëtarë dhe përfaqëson e përkrah personat me aftësi të kufizuara, duke avokuar, lobuar dhe ofruar shërbime për arritjen e të drejtave të barabarta, një jetë të pavarur dhe dinjitoze për të gjithë.

Organizata ofron mbështetje për personat me aftësi të kufizuara (PAK), ndërsa në thelb të angazhimit të saj mbetet avokimi dhe lobimi për krijimin e një infrastrukture ligjore sa më të favorshme për këtë kategori, si dhe monitorimi i zbatimit të legjisllacionit përkatës në komunën tonë.

Handikos Kaçanik ka partneritet strategjik me Handikos Kosova, në të cilën është anëtare. Gjithashtu, gjatë viteve të aktivitetit të saj, organizata ka arritur të ndërtojë partneritete të qëndrueshme me disa organizata ndërkombëtare në dy drejtime kryesore: rritjen e kapaciteteve për ndihmë direkte për PAK dhe zbatimin e projekteve që kanë për qëllim avokimin dhe arritjen e synimeve tona.



## PËRMBAJTJA

7	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
8	GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT
9	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec”
9	Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj”
10	AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL
11	KAPITULLI I - GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË GJITHA PROJEKTET
17	KAPITULLI II - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË LOKACIONET KAÇANIK, BEGRACË DHE KOVAÇEC”
21	KAPITULLI III - GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I TERENEVE SPORTIVE NË BASHKËSITË LOKALE DOGANAJ - SOPONICË, DURAJ”
24	PËRFUNDIME/REKOMANDIME
24	Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve
25	Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit
25	Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit
26	Rekomandimet për investime të reja në projektin e rregullimit të hapësirave në Kovaçec
26	Rekomandimet për investime të reja në projektin e tereneve sportive në Doganaj - Soponicë, Duraj
27	METODOLOGJIA
28	Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?
28	Si u grumbulluan të dhënat?
29	Validimi i të dhënave
29	Përbërja e ekipit
30	Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social
31	EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË KAÇANIK
32	LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT
33	LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Në përputhje me metodologjinë e paracaktuar, organizatat joqeveritare lehtësuan procesin e themelimit të ekipit të “Auditimit Social” në Komunën e Kaçanikut. Brenda tre muajsh, ekipi u angazhua në mbikëqyrjen e dy projekteve investive me vlerë të përgjithshme rreth 502 mijë euro, duke përfshirë ndërtimin dhe rregullimin e hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec dhe ndërtimin dhe rregullimin e tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj-Soponicë e Duraj.

Ekipi i Auditimit Social punoi në grupe të veçanta për monitorimin në terren dhe pas përfundimit të analizimit të projekteve, zhvilloi konsultime të përbashkëta për evidentimin e gjetjeve të përgjithshme dhe specifike për secilin projekt. Nga monitorimi u identifikuan një sërë çështjesh kryesore lidhur me transparencën, cilësinë e punimeve dhe respektimin e afateve kohore. Bazuar në këto gjetje, u përgatitën rekomandime konkrete për komunën për përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe monitorimit të projekteve publike.

Komuna e Kaçanikut është një nga komunat përfituese të Grantit të Performancës Komunale. Për të rritur cilësinë e projekteve të financuara nga ky grant, një ekip aktivistësh të shoqërisë civile nga Kaçaniku, i mbështetur nga projekti DEMOS, nisi në gusht 2025 nismën e angazhimit qytetar në mbikëqyrjen e implementimit të projekteve publike.

Auditimi Social në Kosovë ka filluar të aplikohet nga projekti DEMOS përmes lehtësimit të organizatave të shoqërisë civile që nga viti 2022 dhe është zhvilluar më tej gjatë viteve 2023–2025. Me mbështetjen e projektit DEMOS dhe MAPL-së janë themeluar 35 grupe me më shumë se 700 qytetarë aktivë. Me mbi 700 anëtarë të përfshirë ndër vite, ekipet e Auditimit Social kanë ofruar mbi 200 rekomandime konkrete për përmirësimin e

qeverisjes lokale dhe rritjen e transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, BIRN dhe D+ së bashku me gjashtë organizata lokale — HANDIKOS Istog, HANDIKOS Kaçanik, HANDIKOS Drenas, OJQ Avoko, YAHR dhe MAMUŞA EMEKÇI KADINLAR DERNEĞİ me mbështetjen e DEMOS, themeluan gjashtë ekipe të Auditimit Social në komunat Dragash, Drenas, Lipjan, Mamushë, Kaçanik dhe Istog. Këto ekipe mbikëqyrën 16 projekte të komunave përfituese dhe u aftësuan përmes trajnimeve të specializuara në bazat e Auditimit Social, menaxhimit financiar dhe komunikimit strategjik.

Në Kaçanik, pas hulumtimit dhe konsultimeve me komunitetin, mbi 20 qytetarë u ftuan për t’u bërë pjesë e ekipit të Auditimit Social.

Në nisje të procesit të Auditimit Social u zhvillua programi i trajnimeve në të cilat përfshinë ligjërime dhe këshillime praktik në terren, duke përfshirë vendosjen e kontakteve me komunën, nënshkrimin e memorandumit me komunën dhe kërkesat për qasje në dokumente publike.

Brenda dy muajve ekipi në përbërje të ndryshme kreu mbi 15 vizita në terren dhe mbi 10 takime zyrtare me përfaqësuesit e komunës në lidhje me implementimin e projektit. Gjatë procesit të punës ekipi hartoi rekomandime konkrete, të cilat u ndanë me komunën dhe për të cilat Komuna e Kaçanikut u zotua për zbatimin e tyre.

Ky proces tregon rëndësinë e angazhimit qytetar në rritjen e transparencës, përmirësimin e menaxhimit të projekteve publike dhe fuqizimin e organizatave lokale në qeverisjen komunale.

## GJETJET E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL GJATË PROCESIT



Komuna e Kaçanikut nuk i ka zbatuar në plotni standardet e proklamuar nga Udhëzuesi Administrativ për Administratë të Hapur në procesin e organizimit të dëgjimeve buxhetore.



Në zonat ku janë kryer punimet nuk ka pasur udhëzime të qarta për implementimin dhe detajet e projektit, siç kërkohet në udhëzimin e MAPL-së për transparencë.



Përkundër faktit që projektet prekin direkt komunitetin, projektet investive nuk janë diskutuar në publik me qytetarët në fazën e tyre të planifikimit dhe komuna nuk ka të dhëna për konsultime të tilla.



Komuna nuk ka ndërmarrë masa për të siguruar vendpunishten ku po zhvillohen punët.



Projektet nuk janë të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.



Investimet kanë dëmtuar infrastrukturën publike gjatë implementimit të punimeve.



Zonat ku janë kryer investimet nuk janë shenjëzuar me shenja të rrezikut për të parandaluar aksidentet e komunikacionit.



## Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec”



Projekti ishte kërkesë e qytetarëve mirëpo në zonë mungojnë informacionet për të dhënat e projektit.



Vendpunishtja është e pasigurtë dhe projekti ka dëmtuar infrastrukturën publike.



Projekti nuk e ka të planifikuar qasjen për personat me aftësi të kufizuara.



Hapësira e destinuar për park është e pamjaftueshme për komunitetin.



## Gjetjet specifike në projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj”



Projekti është pjesërisht i qasshëm për personat me aftësi të kufizuara.



Punimet në disa hapësira nuk janë me cilësinë e duhur.



Projekti nuk e ka një plan për mbrojtjen nga rrëshqitja e dheut.



# AMBIENTI NË TË CILIN ZHVILLOHET PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Me një popullsi prej 27,775 banorësh, Komuna e Kaçanikut renditet ndër komunat me madhësi pothuajse mesatare në territorin e Kosovës.

Rezultatet e regjistrimit të popullsisë REKOS2024 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)<sup>1</sup>, tregojnë se Kaçaniku është më i përafërt me Deçanin, ndërsa menjëherë pas tij vjen Komuna e Dragashit.

Komuna e Kaçanikut ka një buxhet të përgjithshëm prej 12,592,238 euro<sup>2</sup>. Nga kjo shumë, 3,473,583 euro janë paraparë për projekte kapitale, që përfaqësojnë 27.58% të totalit të buxhetit.

**Falë menaxhimit të mirë dhe rezultateve të arritura, Komuna e Kaçanikut është përfshirë ndër përfituesit e Grantit të Performancës Komunale. Nga ky grant, i mbështetur nga projekti DEMOS dhe MAPL, Kaçaniku ka përfituar rreth 502 mijë euro investim për dy projekte.**

Paratë e fituara, Komuna e Kaçanikut vendosi t'i investojë në projektin "Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec", dhe ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj.

Projekti u shpall më 07.07.2025, dhe Autoriteti Kontraktues rekomandoi Operatorin Ekonomik "Rema Company Sh.P.K" për kontratë, me ofertë totale 241,111.11 euro. Procesi i prokurimit u finalizua me nënshkrimin e kontratës.

Ky projekt përfshin ndërtimin dhe përmirësimin e hapësirave publike dhe infrastrukturës rrugore në Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec, duke përfshirë ndërtimin e parqeve rekreative me kënde lojërash për fëmijë, mbjelljen e drunjeve dekorative, instalimin e ndriçimit publik LED dhe përgatitjen e terrenit me punime të ndryshme si gërmimi, shtrimi i asfaltit dhe ndërtimi i sistemit të drenazhimit. Projekti parasheh po ashtu edhe ndërtimin e rrugës lidhëse në Begracë, si dhe ndërtimin e dy parkingjeve në fshatin Kovaçec.

Komuna zgjodhi si projekt të dytë "Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj – Soponicë Duraj". Thirrja publike për kontratë u realizua më 16.06.2025, ndërsa kontrata u finalizua me nënshkrimin më 01.08.2025 me Operatorin Ekonomik NNP "ATC COM" Sh.P.K, me vlerë 260,885.45 euro.

Nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave monitoruese në terren, ekipi i Auditimit Social identifikoi problematika në të gjitha fazat e projekteve nga planifikimi dhe kontraktimi deri te zbatimi praktik, duke përfshirë vonesa të mundshme, cilësi të pamjaftueshme dhe nevojën për investimet shtesë.

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës [ASK]\_Regjistrimi i Popullsisë 2024: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ea5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf>

<sup>2</sup> Ligji NR. 08/L-260 Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=99639>

## KAPITULLI I

# GJETJET E PËRBASHKËTA NË TË GJITHA PROJEKTET



### Gjetjet në organizimin e dëgjimeve buxhetore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me mbështetjen e projektit DEMOS në vitin 2023 ripërcaktoi normativën ligjore mbi të cilën komunat e vendit zhvillonin procesin e konsultimit me qytetarët. Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna përcaktoi standarde të avancuara në të cilat komunat organizojnë konsultimet me qytetarët dhe i publikojnë të dhënat publike.

Mbi këtë udhëzim komunat zhvillojnë takime me qytetarët me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të tyre në vendimmarrje. Sipas parimeve, Komuna konsulton qytetarët nëpërmjet:

- Takimeve publike;
- Konsultimit publik për projekte, aktet normative dhe dokumente të politikave;
- Takime konsultative me qytetarë;
- Dëgjime buxhetore.

Ekipi i Auditimit Social gjatë programit të trajnimeve u pajis me njohuri për obligimet e komunave për të zhvilluar procesin e konsultimeve publike dhe mbi këto parime kontrolloi nëse komuna e Kaçanikut kishte zbatuar standardet minimale të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur.

**Auditimi Social ka shqyrtuar përfshirjen qytetare në konsultimet publike të Komunës së Kaçanikut, duke marrë parasysh pjesëmarrjen gjinore, përfshirjen e kërkesave qytetare në buxhet, mundësitë e pjesëmarrjes, transparencën dhe publikimin e materialeve online sipas standardeve të vendosura.**

Gjithashtu, janë vlerësuar nëse projektet “Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive në Doganaj-Soponicë dhe Duraj” dhe “Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec”, janë kërkesa të qytetarëve dhe nëse komuna ka zhvilluar takime pas vendosjes së projekteve për të diskutuar për sugjerimet dhe rekomandimet e qytetarëve. Madje për këto çështje ka kërkuar edhe përgjigje me shkrim nga komuna.

Në faqen zyrtare të saj, Komuna e Kaçanikut i ka publikuar materialet e dëgjimeve buxhetore. Ekipi i Auditimit Social gjeti se numri i pjesëmarrësve është i ulët, e sidomos i grave. Gjithashtu, inkurajohet komuna të gjej mundësi që në takime të tilla të ftohen e të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Organizatat Joqeveritare që merren me mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Sipas raportit, në takimet për konsultime buxhetore me qytetarë për KAB, morën pjesë 30 qytetarë, ku prej tyre 15 ishin gra; në konsultime buxhetore për sektorin e arsimit morën pjesë 14 persona, prej tyre 5 ishin gra. Komuna ka organizuar dëgjime buxhetore edhe me OJQ-të dhe klubet sportive, ku numri i pjesëmarrësve ishte 18, prej të cilëve 13 ishin gra dhe 5 burra. Komuna kishte realizuar takime për diskutimet buxhetore edhe me të rinjtë e kësaj komune. Pjesëmarrja e të rinjve ishte 16, 4 prej tyre ishin të gjinisë femërore.

Komuna buxhetin e diskutoi edhe me bizneset dhe fermerët. Në takim me bizneset morën pjesë 17 persona, prej tyre 14 gra, ndërsa në takimin me fermerë, morën pjesë 19 persona, 4 gra dhe 15 burra.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Raporti mbi konsultimet publike\_22.08.2025: <https://kacanik.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/Raport-i-i-konsultimeve-publike-i-ri.pdf>

Nga analizimi i procesverbaleve të dëgjimeve dhe raportit është konstatuar se janë hartuar sipas rregullave mirëpo përmbajtja e tyre duhet të avancohet. Të dhënat nga procesverbalet dhe raportet finale pati raste ku përmbajtja është e mangët dhe kërkesat e qytetarëve janë evidentuar shkurt ndërsa arsyetimet për pranimin ose mospranimin e kërkesave të qytetarëve janë të shkurta.

Ekipi gjeti se nga gjithsej pjesëmarrësit, maksimumi i personave që parashtruan kërkesa ishte 9, ndërsa mesatarisht 5-6 persona ishin aktivë në paraqitje të kërkesave. Megjithatë, pati edhe raste kur u pranuan kërkesa online. Kjo tregon një nivel të ulët të pjesëmarrjes aktive në procesin e paraqitjes së kërkesave.

Ekipi rekomandon që të rritet informimi dhe promovimi i mënyrave të ndryshme për paraqitjen e kërkesave, duke përfshirë kanalet online, për të lehtësuar pjesëmarrjen

e qytetarëve dhe për të siguruar që më shumë kërkesa të merren në konsideratë. Gjithashtu, mund të merren parasysh masa që inkurajojnë angazhimin e pjesëmarrësve gjatë takimeve ose konsultimeve publike.

Një element tjetër që grupi e ka evidentuar gjatë diskutimeve publike është individualizimi i kërkesave. Në procesverbalet e analizuara grupi ka konstatuar se kërkesat që shpeshherë janë grupore i atribuohen vetëm një qytetari dhe kjo tregon humbje të legjitimitetit të kërkesës.

Ekipi Auditimit Social ka vënë re se përveç formave të parashikuara me ligj të konsultimeve buxhetore, kryetari i Komunës së Kaçanikut çdo ditë pranon në zyre të tij qytetarët e në veçanti administratorët e fshatrave dhe lagjeve, me të cilët diskuton për kërkesat dhe nevojat e tyre.



## Gjetjet në diskutimin e projekteve investive

Neni 17 i [Udhëzimit për Administratë të Hapur në Komuna](#) ka promovuar standardin që projektet investive të diskutohen me komunitetin në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Mbi këtë standard, hartuesit e projekteve dhe komunat do t'i diskutonin projektet para nisjes së implementimit të tyre me qëllim që projektet të jenë të plota dhe të familjarizuara për tërë komunitetin.

Mbi këtë standard, para nisjes së procesit të prokurimit dhe gjatë fazës së hartimit të projektit, komunat do të organizonin takime me qytetarët për të prezantuar projektin, mjetet në dispozicion dhe ndikimin e tij në komunitetin lokal.

Ekipi i Auditimit Social në Kaçanik ka konstatuar se për projektet në Kaçanik nuk janë zhvilluar takime të tilla formale me komunitetin. Si rrjedhojë, projektet kanë pasur nevojë për ndërhyrje dhe sanim të problemeve gjatë dhe pas implementimit të tyre.

Ekipi i Auditimit Social në Kaçanik ka konstatuar se për projektet e realizuara në komunë nuk janë zhvilluar takime formale konsultuese me komunitetin para fillimit të punimeve. Mungesa e një procesi të tillë të konsultimit ka bërë që projektet të mos pasqyrojnë në mënyrë të saktë nevojat dhe prioritetet reale të banorëve. Si rezultat, gjatë implementimit dhe pas përfundimit të punimeve është dashur të bëhen ndërhyrje korrigjuese.

Këtë e dëshmon edhe deklarimi i menaxherit të kontratës, Rufat Muqa, në takimin e datës 21.10.2025, ku ai sqaroi se projekti në fshatin Begracë duhet të ndryshohet për shkak të kërkesave të banorëve.

“Ne e kemi pasë në projekt një rrugë në mes, ne po dojmë ta heqim komplet rrugën, në koordinim me administratorin, për shkak se tani lindin dy kërkesa të tjera. Rruga e paraparë në mes, të hiqet krejt.”<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Takim me Menaxherin e Kontratës, Rufat Muqa\_21.10.2025

Raste të tilla po përsëriten edhe në projektin tjetër të terreneve sportive, ku po bëhen ndryshime të ngjashme gjatë fazës së implementimit. Këto situata tregojnë qartë se mungesa e konsultimeve paraprake me komunitetin para hartimit të projekteve ka prodhuar zgjidhje të papërshtatshme, duke e detyruar komunën të rikthehet tek projektet e miratuara dhe t'i rishikojë ato në mënyrë ad-hoc.

Për të gjitha këto arsye, ekipi i Auditimit Social konstaton se organizimi i takimeve të rregullta dhe të formalizuara me komunitetin është i domosdoshëm që projektet të planifikohen saktë, të implementohen pa vonesa dhe të shmangen ndërhyrjet e panevojshme gjatë apo pas realizimit të tyre.

### Neni 17

#### Format përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje

1. Komuna duhet të siguroj përfshirjen e qytetarëve në konsultime dhe vendimarrje duke përdorur por duke mos u kufizuar në mbajtjen e:

1.1 Takimeve publike;

1.2 Konsultim publik për projekt aktet normative dhe dokumente të politikave;

1.3 Takime konsultative me qytetarë;

1.4 Dëgjime buxhetore.

2. Trajtimin e kërkesave peticioneve dhe kërkesave individuale e grupeve të qytetarëve.

3. Me qëllim të marrjes së pikëpamjeve të qytetarëve në procesin vendimarrës, komuna siguron zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik të përcaktuara në këtë udhëzim Administrativ.

4. Me qëllim të dokumentimit të mbajtjes së takimeve, konsultimeve publike, dëgjimeve buxhetore dhe takimeve tjera, komuna siguron ftesat, materialet, sigurimin e kushteve, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e raportit nga takimet dhe aktivitetet e përfshirjes së qytetarëve në diskutime dhe konsultime publike, gjatë hartimit të akteve dhe dokumenteve lokale.

5. Ueb-faqja e komunës dhe platforma qeveritare për konsultime publike do përdoren si platforma për realizimin e qëllimeve të këtij neni.

6. Zyra për Komunikim me Publikun, është përgjegjëse për njoftimin e qytetarëve për vendin, datën, kohën vendin, rendin e ditës, se kur do të mbahen takimet, degjimet buxhetore, konsultimet publike dhe takime tjera shtesë.



### Gjetjet në zbatimin e obligimit për të njoftuar qytetarët

Udhëzimi Administrativ për Administratën e Hapur të komunave kërkon nga autoritetet lokale që për të gjitha projektet investive komuna t'u ofrojë qytetarëve informacione të mjaftueshme për projektin. Mbi këto parime, komunat duhet të publikojnë kontratat dhe projektet investive në faqet e tyre zyrtare duke u mundësuar qytetarëve qasje në to.

Gjatë monitorimit, ekipi ka vërejtur se kontratat janë publikuar në E-prokurim, së bashku me disa të dhëna të tjera. Megjithatë, transparenca e komunës ndaj qytetarëve për projektet konkrete është e kufizuar, pasi projektet ekzekutive dhe dokumentet kyçe, si raporti i menaxherit të kontratës dhe faturat për punët e kryera, nuk janë publikuar.

Ligji për Prokurimin Publik e bën transparencën parim bazë dhe kërkon që autoritetet kontraktuese të publikojnë dokumentet kryesore të procedurës së prokurimit, ndërsa për dokumentet e ekzekutimit të kontratës të sigurojnë qasje me kërkesë nga publiku. Kjo përfshin plane, specifikime dhe dokumente që lidhen me menaxhimin e kontratës, për sa këto nuk përmbajnë informata të klasifikuara si sekret tregtar. Në këtë kuadër, plani i menaxhimit të kontratës dhe dokumentet që lidhen me monitorimin e saj konsiderohen dokumente të qasshme ligjërisht.

Raportet e menaxherit të kontratës, vlerësimet e performancës dhe dokumentet operative të ekzekutimit nuk publikohen automatikisht, por mund t'u jepen qytetarëve me kërkesë zyrtare, në pajtim me ligjin për qasje në dokumente publike. E njëjta vlen edhe për faturat dhe pagesat: edhe pse nuk publikohen në mënyrë të rregullt në platformën e prokurimit, ato janë pjesë e dokumenteve të ekzekutimit të kontratës që mund të kërkohen dhe shpërndahen, përveç kur përmbajnë informata të mbrojtura.

Andaj ekipi i Auditimi Social rekomandon që komuna të avancojë transparencën, duke publikuar në mënyrë proaktive edhe dokumentet ekzekutive të kontratave si projektet ekzekutive, përshkrimet teknike, raportet e menaxhimit dhe të dhënat kryesore mbi pagesat. Në praktikë, disa autoritete kontraktuese tashmë e kanë bërë këtë, duke publikuar projekte ekzekutive dhe dokumentacion teknik, çka ka rezultuar në rritjen e llogaridhënies dhe besimit publik. Kjo qasje do të ishte një praktikë e mirë edhe për komunën, pasi rrit dukshëm transparencën dhe

ul hapësirën për keqinterpretime apo dyshime gjatë realizimit të kontratave publike.

Për çdo projekt, komuna vendos pano informuese për aktivitetin e prokurimit, në të cilën shkruhet emri i projektit, investitori, kompania implementuese dhe kohëzgjatja. Me qëllim të rritjes së transparencës, komuna duhet të vendosë emrin, mbiemrin dhe kontaktet e menaxherit, mbikëqyrësit apo kompanisë mbikëqyrëse të projektit.

Në këtë situatë, ekipi ka analizuar edhe transparencën e projekteve në vendin ku ato ishin duke u zhvilluar. Sipas UA-së, komuna duhet të vendosë në secilin vendpunishte pano informuese në të cilat përmendet qartë investitori dhe emërohet personi i cili mbikëqyr kontratën.

Ekipi ka konstatuar se në projektin e rrugëve të dhënat e tilla mungojnë, pasi komuna nuk ka vendosur pano apo njoftime, ashtu siç e kërkon Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna.



## Gjetjet në sigurinë e vendpunishtes

Ekipi i Auditimit Social në Kaçanik, gjatë vizitave në terren, ka konstatuar se Komuna e Kaçanikut nuk i ka obliguar kompanitë që t'i zbatojnë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në zonat ku janë zhvilluar punime në rrugë nuk janë vendosur shenja paralajmëruese apo sinjalizime për punimet në zhvillim, ndërsa zona ku janë kryer ndërtimet në park ka qenë e parrethuar sipas standarteve.

Gjetja është edhe më e rëndësishme duke pasur parasysh se ligji obligon kompanitë dhe organet përgjegjëse të ndërmarrin masa për të siguruar vendpunishtet, duke garantuar që ato të jenë të rrethuar, të sinjalizuara dhe të ofrojnë udhëzime për qytetarët dhe punëtorët mbi rreziqet. Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor rrit ndjeshëm rrezikun për aksidente dhe dëmtime fizike.

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë obligon punëdhënësit dhe organet përgjegjëse të ndërmarrin masa për të siguruar vendin e punës dhe për të mbrojtur punëtorët nga rreziqet. Ligji përcakton përgjegjësinë e punëdhënësit për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut, krijimin e kushteve të sigurta të punës, trajnimin e punëtorëve dhe dhënien e udhëzimeve për përdorimin e pajisjeve dhe makinerive. Ai gjithashtu kërkon që punëdhënësi të caktojë persona të trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, të cilët monitorojnë dhe zbatojnë masat parandaluese, duke përfshirë dokumentimin e rreziqeve dhe masave të marra për parandalimin e tyre.

Detajet specifike për sinjalizimin dhe rrethimin e vendeve të rrezikshme nuk përfshihen drejtpërdrejt në ligj, por janë të përcaktuara në aktet nënligjore.

Për projektin ndërtimi dhe rregullimi i parkut në Kovaçec, siguria përmendet edhe në përshkrimin teknik të projekti - "Para fillimit të punës punëkryesi duhet të ofrojë planin e sigurisë për punëtorët dhe planin e sigurimit të objektit deri në 10m. Po ashtu duhet të lajmërohet me shenja të rrezikut për njerëzit që lëvizin rreth objektit."

Gjithashtu kjo pikë është edhe si pozicion në paramasën dhe parallogarinë e projektit.

Mungesa e masave të sigurisë në vendpunishtet publike paraqet rrezik serioz për sigurinë e qytetarëve dhe punëtorëve. Zonat e pambrojtura dhe pa sinjalizim mund të shkaktojnë aksidente, rënie ose lëndime fizike, përfshirë dëmtime të mjeteve, dhe krijojnë rrezik për përgjegjësi ligjore dhe financiare për komunën, si dhe dëmtojnë reputacionin e institucionit për moszbatim të standardeve bazë të sigurisë dhe mbrojtjes në punë.



## Projektet nuk janë familjare për personat me aftësi të kufizuara

Gjatë mbikëqyrjes në terren, ekipet e Auditimit Social i kanë kushtuar rëndësi të madhe mbikëqyrjes së zbatimit të qasjes për personat me aftësi të kufizuara në projektet investive. Në dy projektet, ato të parkut dhe të fushës, ekipet kanë konstatuar probleme sistematike me zbatimin e standardeve të qasjes.

Në projektin për ndërtimin dhe rregullimin e hapësirave publike e parkut, ekipi nuk ka gjetur të dhëna se komuna planifikon të rezervojë parkingje për personat me aftësi të kufizuara dhe të bëjë hapësirat të qasshme për personat e verbër me pllakat taktile. Përpos kësaj, është vërejtur që në zonë nuk ka plane që parku i lodrave të jetë familjar për personat me karroca.

Pas diskutimit të kësaj çështje dhe dërgimit të rekomandimeve, Komuna e Kaçanikut është zotuar se do të vendosë në zonë karrige për

personat me aftësi të kufizuara, lodra për fëmijët me aftësi të kufizuara. Probleme me qasjen e personave me aftësi të kufizuara janë konstatuar edhe në projektin e fushave sportive. Në zonë, ekipi ka konstatuar se trotualet nuk janë ndërtuar sipas standardeve për lëvizjen e personave të verbër, ndërsa rruga e cila të dërgon deri tek fusha nuk ishte e qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Në afërsi të zonës nuk ka parking për personat me aftësi të kufizuara dhe në fushat e sportit nuk ka ulëse për personat me aftësi të kufizuara. Gjatë takimeve me përfaqësues të komunës, ekipi pati marrë zotime nga Komuna se do ndërhyjë duke shtuar një rrugë me qasje për personat me aftësi të kufizuara dhe ulëse për të njëjtit. Gjatë vizitave në terren, ekipi i Auditimit Social ka evidentuar se Komuna ka krijuar qasjen e re dhe më të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar.



## Zonat nuk janë siguruar nga shembjet e dheut

Gjatë vizitave në terren, ekipi ka vërejtur se dy projektet janë zhvilluar në hapësira të pjerrëta ku është gërryer dheu. Në hapësirën e parkingut dhe parkut, nga punimet disa zona janë shembur dhe asfalti është dëmtuar

si pasojë e punimeve. Rrezik për shembje është konstatuar edhe në projektin e fushave sportive. Planifikimi i sigurisë së zonës nga rrëshqitja është i domosdoshëm për shkak të rritjes së sigurisë në punime.



## Mungesa e planifikimit të mirëmbajtjes

Gjatë vlerësimit të projekteve, ekipi konstatoi se komuna nuk ka të angazhuar personel të dedikuar për mirëmbajtjen e dy projekteve kryesore – parkut dhe fushave sportive. Mirëmbajtja e projekteve është një element thelbësor për sigurimin e funksionimit afatgjatë dhe për mbrojtjen e investimit publik.

Projektet që nuk mirëmbahen rrezikojnë të dëmtohen nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë vjedhjet, shfrytëzimin jo të duhur, dëmtimet nga kushtet atmosferike dhe degradimin natyror të materialeve. Mungesa e mirëmbajtjes jo vetëm që zvogëlon jetëgjatësinë e projekteve, por gjithashtu kufizon përdorimin e tyre nga qytetarët dhe dëmton besimin e komunitetit ndaj investimeve publike.

Mirëmbajtja e rregullt siguron që infrastruktura të mbetet funksionale, e sigurt dhe e qasshme për të gjithë përdoruesit. Ajo kontribon gjithashtu në optimizimin e burimeve, pasi riparimet e vogla të kryera në kohë shmangin shpenzime më të mëdha në të ardhmen për riparime ose rindërtim të projekteve të dëmtuara. Për më tepër, mirëmbajtja është një element i rëndësishëm i menaxhimit transparent dhe të përgjegjshëm të investimeve publike.

Ndryshe, me kontratë periudha garantuese është 365 ditë ndërsa 365+30 ditë, në vlerë 10% të vlerës së kontratës. Ndërsa për planifikim të mirëmbajtjes afatgjatë, ekipi nuk ka pranuar ndonjë përgjigje.

## KAPITULLI II

# GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË LOKACIONET KAÇANIK, BEGRACË DHE KOVAÇEC”



### Mungesa e tabelës informuese në vendpunishte

Gjatë vizitës në terren, ekipi i Auditimit Social konstatoi se në vendpunishten e projektit nuk ishte vendosur tabela informuese që përmbante të dhënat përkatëse, si emri i projektit, investitori dhe punëkryesi. Mungesa e kësaj tabele kufizon mundësinë e publikut dhe të palëve të tjera të interesuara për të marrë informacion të qartë dhe të saktë mbi projektin, duke reduktuar transparencën e proceseve të punës dhe menaxhimin e përgjegjësive.

Tabela informuese është një mjet i rëndësishëm për publikun dhe autoritetet mbikëqyrëse, pasi siguron që informacioni bazë

i projektit të jetë i qasshëm për të gjithë, duke përfshirë detajet mbi investitorin, punëkryesin, kohëzgjatjen e projektit dhe objektin e tij. Kjo jo vetëm që përmirëson transparencën, por gjithashtu rrit besimin e komunitetit ndaj zbatimit të projektit dhe lehtëson monitorimin e punimeve nga autoritetet përkatëse.

Menaxherit të kontratës i rekomandohet vendosja e tabelës informuese në mënyrë të dukshme në vendpunishten e projektit. Kjo do të sigurojë informimin e publikut, do të rrisë transparencën e projekteve dhe do të përforcojë përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen gjatë realizimit të punimeve.



### Mungesa e kontraktimit të sigurisë në vendpunishte

Gjatë inspektimit në terren, ekipi i Auditimit Social evidentoi se vendpunishtja nuk ishte e rrethuar, duke krijuar rrezik potencial për punëtorët dhe banorët e zonës përreth. Mungesa e rrethimit është rezultat i mosplanifikimit dhe mungesës së vlerës adekuate në kontratë, ku rrethoja ishte përcaktuar si pozicion, por me një vlerë simbolike prej vetëm 1 euro.

Menaxheri i kontratës, Rufat Muça, ka argumentuar se punimet realizohen vetëm sipas kontratës dhe se çështja e sigurisë në punë nuk është e parashikuar në mënyrë të detajuar në parametrat e kontratës.

Megjithatë, siguria në punë është një nevojë thelbësore që shtrihet përtej kufizimeve të kontratës, pasi mbrojtja e jetës dhe shëndetit të punëtorëve dhe banorëve është prioritet i ligjshëm dhe profesional.

Bazuar në këtë, kërkesa për rrethim të vendpunishtes është e arsyeshme dhe e domosdoshme, jo vetëm për të përmbushur një kërkesë kontraktuale, por edhe për të garantuar sigurinë fizike, parandalimin e aksidenteve dhe respektimin e standardeve të punës dhe mbikëqyrjes së projekteve.



## Mungesa e planifikimit të qasjes

Gjatë monitorimit, ekipi konstatoi se projektet nuk janë të standardizuara për të plotësuar nevojat minimale të shtresave të marginalizuara, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Problemi kryesor lidhet me mungesën e planifikimit të duhur, pasi në detyrat projektuese nuk ishte specifikuar në mënyrë konkrete që projektet të jenë të qasshme dhe familjare për këto grupe. Kjo tregon se çështja kryesore është planifikimi i projekteve, dhe përmirësimi i tij është thelbësor për të siguruar transparencë, pjesëmarrje dhe përfitim të barabartë për të gjithë.

Ekipi konstaton se në projektin e rregullimit të hapësirave publike nuk janë paraparë shenjat taktile për personat e verbër, si dhe nuk është planifikuar parkimi i rezervuar për personat me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që ky aspekt të merret parasysh në projektet e


ardhshme, në mënyrë që hapësirat publike të jenë të qasshme dhe të sigurt për të gjithë përdoruesit. Një nga çështjet e ngritura nga ekipi i Auditimit Social ka qenë edhe qasja për personat me aftësi të kufizuara. Ndër to ishte hyrja që çonte në fushat sportive e cila ishte e papërshtatshme për përdorues të karrocave dhe për nëna me fëmijë, prandaj ekipi ka kërkuar krijimin e një hyrjeje tjetër më të përshtatshme.

Komuna e ka adresuar këtë rekomandim duke krijuar qasjen e re, kjo konfirmohet edhe në përgjigjen e vet Komunës së Kaçanikut.

“Qasja në terrenet sportive dhe në hapësirën rekreative për personat me aftësi të kufizuara është e lehtë dhe në përputhje me standardet përkatëse. Në bazë të kërkesave që kanë dalë si rrjedhojë e Auditimit Social, është realizuar edhe një hyrje e re.”<sup>5</sup>



<sup>5</sup> Komuna e Kaçanikut\_Pëgjigje me shkrim\_14.11.2025



## Mangësi gjatë punimeve

Gjatë vizitave në vendpunishte, ekipi i Auditimit Social gjeti se struktura e armaturave ishte vendosur direkt mbi sipërfaqen e tokës, pa një bazë të përgatitur për betonim. Kjo gjendje paraqet disa rreziqe të rëndësishme: armaturat janë të ekspozuara ndaj dëmtimeve mekanike dhe lagështisë, duke rritur mundësinë e korrozionit ose deformimit. Përveç kësaj, mungesa e një baze të stabilizuar mund të pengojë realizimin e një betonimi të sigurtë dhe të qëndrueshëm, duke kompromentuar qëndrueshmërinë.

Ekipi konstaton se kjo situatë tregon nevojën për respektimin e standardeve teknike gjatë vendosjes së materialeve përforcuese, përfshirë përgatitjen e një baze të përshtatshme dhe ruajtjen e materialeve në kushte të sigurta deri në fazën e betonimit. Zbatimi i këtyre masave do të zvogëlojë rrezikun e dëmtimeve, do të përmirësojë cilësinë e punimeve dhe do të sigurojë që betonimi të realizohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurtë.

Gjatë vizitave në terren në vendpunishte, ekipi i Auditimit Social vërejti se armaturat ishin vendosur mbi tokë pa një bazë të përgatitur për betonim, duke rritur rrezikun e dëmtimit të materialeve dhe pamundësinë për një betonim të sigurtë dhe të qëndrueshëm. Menaxheri i kontratës, Rufat Muqa, e konfirmoi këtë gjetje dhe deklaroi se kishte ndërhyrë duke shtuar


bazën prej zhavorri përpara se të vazhdohej me punimet. Kjo situatë tregon nevojën për planifikim dhe kontroll më të rreptë të përgatitjes së terrenit para vendosjes së materialeve kritike.

Sipas banorëve dhe vëzhgimeve në terren, toka në këtë pjesë është e rrëshqitshme. Ekipi konstatoi se nevojitet testim i rrëshqitjes së dheut për të identifikuar zonat e rrezikshme dhe për të parandaluar aksidente gjatë punimeve. Ky test është i domosdoshëm për të siguruar stabilitetin e konstruksioneve dhe për të planifikuar masat mbrojtëse të nevojshme.

Rruga që kalon pranë vendpunishtes është frekuentuar nga kalimtarë dhe automjete. Ekipi vërejti mungesën e sinjalistikës së duhur rrugore, e cila është e nevojshme për të parandaluar rënien e kalimtarëve dhe automjeteve në zonën e punimeve. Sigurimi i sinjalistikës është një masë kritike për mbrojtjen e jetës dhe pronës gjatë punimeve.

Problemet e konstatuara tregojnë nevojën për një menaxhim më të mirë të terrenit dhe sigurimin e kushteve të punës, përfshirë përgatitjen e bazave, vlerësimin e stabilitetit të tokës dhe vendosjen e sinjalistikës mbrojtëse. Këto masa janë thelbësore për të garantuar sigurinë e punëtorëve, të banorëve dhe të automjeteve që frekuentojnë zonën.





## Nevoja për planifikim të shenjave të rrezikut


Gjatë vlerësimit të zonës së rrugës, ekipi i Auditimit Social konstatoi mungesën e masave të mjaftueshme për sigurinë e pjesëmarrësve në komunikacion. Konkretisht:

**Vija të bardha me disnivel ose teksturë me dridhje:** Ekipi vlerëson se është e nevojshme vendosja e vijës me teksturë që krijon dridhje, e cila detyron përdoruesit e rrugës të ngadalësojnë shpejtësinë, duke rritur sigurinë për këmbësorët dhe për automjetet.

**Vendkalimi për këmbësorë:** Ndërtimi i një vendkalimi të sigurt për këmbësorët është i domosdoshëm për të parandaluar aksidentet dhe për të organizuar qarkullimin në mënyrë të kontrolluar.

**Sinjalistika dhe tabelat paralajmëruese:** Zona aktuale nuk ka sinjalistikë adekuate. Ekipi evidentoi nevojën për testimin e pjerrtësisë së terenit dhe vendosjen e tabelave përkatëse, për të përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve dhe për të paralajmëruar drejtuesit e tyre mbi rreziqet. Vendosja e sinjalistikës paralajmëruese është thelbësore për të reduktuar rrezikun e aksidenteve.

**Masat e propozuara:** Vijat me teksturë me dridhje, vendkalimi për këmbësorë dhe sinjalistika e duhur – janë të nevojshme për të rritur sigurinë në këtë zonë dhe për të parandaluar aksidentet e mundshme për këmbësorët dhe automjetet.



## Nevoja për ridestnim të projektit

Gjatë procesit të Auditimit Social, ekipi vlerësoi si të nevojshme që t'i propozojë komunës mundësinë e përdorimit të nivelit të mesëm të parkingut si hapësirë për lojëra për fëmijë, ndërsa niveli i tretë të mbetet si parkim. Megjithatë, Menaxheri i Kontratës, Rufat Muqa, e konsideroi këtë të pamundur, duke argumentuar se ndryshimi i destinimit të hapësirës nuk përputhet me nevojat reale të komunitetit dhe të xhamisë, pasi sasia e parkingut aktual duhet të përmbushë kërkesat e dy lagjeve përreth dhe numrin e automjeteve që qarkullojnë.

Si zgjidhje alternative, menaxheri Muqa sygjeroi që një pjesë e nivelit të mesëm të

parkingut të përshtatet me asfalt në vend të kubëzave dhe të vendoset një kosh për aktivitete sportive, në mënyrë që hapësira të mund të shfrytëzohet për rekreacion dhe aktivitete fizike pa komprometuar funksionin kryesor të parkingut.

Ekipi konstaton se është e nevojshme të gjendet një zgjidhje që kombinon funksionin e parkingut me shfrytëzimin për aktivitete sportive dhe rekreative, duke marrë parasysh nevojat reale të komunitetit. Vendosja e asfaltit dhe një kosh për sport mund të jetë një alternativë e qëndrueshme, që maksimizon përdorimin e hapësirës pa ndryshuar destinacionin kryesor të projektit.

## KAPITULLI III

# GJETJET SPECIFIKE PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I TERENEVE SPORTIVE NË BASHKËSITË LOKALE DOGANAJ - SOPONICË, DURAJ”



### Konstatimet në planifikimin e lartësisë mbi porta

Gjatë vizitës në terren, ekipi i Auditimit Social konstatoi se rrethoja prapa portës, megjithëse ka një lartësi prej 4 metrash, konsiderohet e ulët dhe mund të mos ofrojë mbrojtje të mjaftueshme për sigurinë e përdoruesve. Bazuar në këtë, u rekomandua të shqyrtohet mundësia e rritjes së lartësisë së rrethojës për të përmirësuar funksionalitetin dhe sigurinë.

Menaxheri i kontratës, Valmir Krasniqi, shprehu skepticizëm lidhur me ndryshimet e menjëhershme, duke argumentuar se gjatë fazës aktuale të punimeve nuk është e qartë nëse mund të realizohen ndryshime. Ai gjithashtu theksoi mungesën e profileve të nevojshme në fusha të tjera dhe punën shtesë të kryer nga Duraj, e cila ka prekur limitet e materialeve, duke rezultuar në mungesë të një pjese të rrethojës.

Problemi kryesor qëndron tek lartësia aktuale e rrethojës dhe kufizimet materiale që pengojnë ndërhyrjet e menjëhershme. Ekipi evidenton nevojën për rishikim të mundësisë për rritjen e lartësisë së rrethojës në faza të mëvonshme, për të garantuar sigurinë dhe funksionalitetin e saj.

Nga Komuna e Kaçanikut kanë thënë se ekipi menaxhues i projektit “Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë dhe Duraj”, i ka analizuar të gjitha mundësitë që vërejtjet e shprehura gjatë procesit të Auditimit Social t’i trajtojnë dhe t’i inkorporojnë gjatë zbatimit të projektit.

Lidhur me lartësinë e rrethojave prapa portave kanë thënë se aktualisht është e pamundur, ndërsa do të merret parasysh në të ardhmen. “Paraprakisht ju njoftojmë se ne jemi vetëm ekip menaxhues i kësaj kontrate, e cila ka projekt dhe paramasë tashmë të kontraktuar, dhe si e tillë është e pamundur të ndryshohet. Sa i përket konstatimit se rrjetat mbi portat duhet të jenë më të larta, në fazën në të cilën ndodhemi është e pamundur të bëhen ndryshime, pasi rrjetat janë vendosur sipas projektit dhe paramasës. Kjo vërejtje mund të merret parasysh në të ardhmen dhe të realizohet me ndonjë kontratë tjetër, ku rrjetat mund të vazhdojnë nëpërmjet saldimit.”<sup>6</sup>

Ekipi rekomandon që përdorimi i lartësisë më të madhe të rrjetave të merret në konsideratë dhe të zbatohet gjatë ndërtimit të terrenit sportiv në Duraj, i cili bën pjesë në të njëjtën kontratë dhe ende janë në fazën implementuese. Ky rekomandim është për autoritetin kontraktues dhe kontraktorin gjatë zbatimit të punimeve.

Projekti parasheh ndërtimin e terrenit sportiv në fshatin Duraj të Kaçanikut, duke filluar nga punimet përgatitore, gërmimet dhe krijimi i nënbazës.

Punimet përfshijnë largimin e dheut, vendosjen e gjeotekstit, shtresave të agregatit, rërës dhe të gjitha bazave teknike të nevojshme për fushën e futbollit, fushën e volejbollit, zonat e ecjes dhe hapësirave përcjellëse. Në këtë fazë hyjnë edhe punimet me beton, armaturë dhe ngritja e mureve rrethuese dhe tribunave.

<sup>6</sup> Komuna e Kaçanikut\_Pëgjigje me shkrim\_14.11.2025

Pjesa qendrore e projektit përfshin instalimin e barit artificial profesional, vendosjen e kubëzave të betonit, punimin e asfaltit, shenjzimet dhe pajisjet sportive si golat dhe rrjetat. Gjithashtu parashihet të ndërtohet rrethimi i plotë i kompleksit me konstruksione të galvanizuara dhe panele Paladin. Paralelisht realizohet sistemi i drenazhimit, përfshirë rigolat, pusetat e betonit, tubacionet PE SN8 dhe pikën shkarkuese në lumin Lepenc, për të siguruar funksionimin e rregullt hidrik të terrenit.

Një pjesë e rëndësishme e punimeve është edhe ndriçimi, ku përfshihen kanalet për kablllo, instalimi i gypave, kablllove kryesore dhe tokëzimit, vendosja e kuadrit shpërndarës, montimi i 9 shtyllave të ndriçimit 10 m me reflektorë LED 300W dhe i 6 shtyllave të parkut me llampa LED 22W. Projekti përmbyllet me rregullimin e hapësirave të gjelbëruara, mbjelljen e drunjve dekorativë dhe vendosjen e ulëseve dhe shportave, duke krijuar një

ambient të plotë sportiv e rekreativ për komunitetin. Vetëm për ndërtimin e terreneve sportive në Duraj, janë kontraktuar 142,324.65 euro.

Gjatë fazës së monitorimit të projektit nga ekipi Auditimit Social, në fshatin Duraj ishin kryer vetëm punimet e dheut. Bazuar në dokumentet e ofruara nga Menaxheri i Kontratës, vlera e punëve ishte 22,762 euro.

Në anën tjetër, në terrenin sportiv Doganaj-Soponicë, vlera e punëve të realizuara ishte 110,950.40 euro, duke përfshirë punë përgaditore dhe të dheut, të asfaltit, kubëzat, anësoret, shtresat dhe shenjzimet. Po ashtu, pajisjet sportive, betoni dhe armatura, rrethojat e fushës e ndriçimi.

Ndërsa sipas situacionit të dytë të raportit të menaxherit të kontratës, vlera e punëve të realizuara është arritur 65,049 euro në fshatin Duraj, ndërsa punimet në Doganaj kanë arritur vlerën e 111,150.80 euro.



## Konkluzioni që granulati të jetë ekologjik

Granulati është një material i përdorur për mbushjen e sipërfaqeve sportive, i përbërë zakonisht nga copa gome ose materiale të tjera elastike, që siguron një sipërfaqe të butë dhe të amortizuar për lojtarët. Ai ndihmon në uljen e goditjeve, parandalon dëmtime dhe siguron një sipërfaqe të qëndrueshme dhe të përdorshme gjatë gjithë vitit.

Gjatë procesit të Auditimit Social, ekipi konstatoi se është e rëndësishme që granulati i përdorur në fushë të jetë ekologjik, për të garantuar sigurinë e përdoruesve, shëndetin e tyre dhe për të respektuar standardet mjedisore. Materiali ekologjik shmang substancat e dëmshme, zvogëlon ndikimin negativ në mjedis dhe siguron që sipërfaqja sportive të jetë e qëndrueshme dhe e përdorshme në periudhë afatgjate.

Në takim me anëtarët e ekipit, menaxheri i projektit u zotua se granulati ekologjik do të përdoret gjatë realizimit të fushës, duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat

mjedisore dhe standardet e sigurisë për përdoruesit.

Përdorimi i granulatit ekologjik është i domosdoshëm për të mbrojtur shëndetin e përdoruesve, për të ruajtur mjedisin dhe për të garantuar që sipërfaqja sportive të jetë e qëndrueshme dhe e sigurtë gjatë gjithë kohës.

Gjatë vizitës së ekipit të Auditimit Social në terrenin sportiv, granulati ende nuk ishte vendosur, pasi vizita u zhvillua para fazës së vendosjes së tij, andaj ekipi pas vizitës rekomandoi që granulati të jetë ekologjik dhe të vendoset siç parashihet me projekt.

Në fazat e mëvonshme, ekipi i Auditimit Social evidentoi se në terrenet sportive ishte vendosur granulati ekologjik. Kjo u konfirmua edhe shkrim nga Menaxheri i Kontratës, Valmir Krasniqi. "Granulati i përdorur gjatë realizimit të projektit është ekologjik, sipas specifikimeve të projektit. Gjatë vizitës tuaj në terren, ai ende nuk ishte vendosur ndërsa tashmë është vendosur në terrenet sportive"<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Komuna e Kaçanikut\_Përgjigje me shkrim\_14.11.2025



## Kubëzat e dëmtuara të zëvendësohen para pranimit teknik

Gjatë vizitës në terren, ekipi konstatoi se disa nga kubëzat dhe anësoret e vendosura janë të dëmtuara, veçanërisht në zonat ku janë vendosur shtyllat. Dëmtimet kanë ndodhur gjatë punimeve, duke ulur cilësinë dhe funksionalitetin e sipërfaqes së punuar.

Menaxheri i kontratës, Valmir Krasniqi, konfirmoi gjetjen dhe theksoi se kjo çështje do të adresohet para pranimit teknik të projektit: “Ne i kemi lexu rekomandimet që i keni dërgu ju. Aty hala nuk ka pranimit teknik,

kubëzat janë dëmtu aty-këtu. Para pranimit teknik, bëhet edhe një vizitë saktë dhe ku ka defekte ndërrohen.” Dëmtimet e konstatuara tregojnë nevojën për ndërhyrje për riparimin ose zëvendësimin e kubëzave të dëmtuara. Sigurimi që kubëzat të jenë të paprekura dhe të funksionojnë siç duhet është i domosdoshëm për pranimin final të projektit dhe për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tij.

Sipas Komunes së Kaçanikut, të gjitha janë në përputhje me kërkesat e projektit. Kubëzat që janë dëmtuar gjatë punimeve janë zëvendësuar.<sup>8</sup>



## Gjetja për ndriçimin e fushës

Gjatë periudhës monitoruese, ekipi i Auditimit Social konstatoi nevojën për vendosjen e shtyllave ndriçuese me dy koka në teren, në mënyrë që të sigurohet ndriçim jo vetëm i sipërfaqes së përdorur, por edhe i rrugës përreth. Diskutimet e ekipit treguan se disa nga trupat ndriçuese mund të përmirësohen duke vendosur dritat në dy anët e shtyllës, duke rritur sigurinë e përdoruesve dhe qarkullimin e automjeteve.

Ky rekomandim është adresuar pjesërisht, pasi komuna ka vendosur ndriçimin në këtë mënyrë vetëm në një pjesë të rrugës, ndërsa nevoja për ndriçim të plotë dhe të uniformuar mbetet e pranishme në pjesët e tjera të territorit.

Vendosja e shtyllave ndriçuese me dy koka është e domosdoshme për të garantuar ndriçim të mjaftueshëm të gjithë zonës dhe për të rritur sigurinë e përdoruesve, duke përfshirë këmbësorët dhe automjetet.

Për këtë çështje komuna zotohet se do të realizohet nëpërmjet kontratave të tjera. “Ndriçimi në terene sportive është realizuar sipas projektit ndërsa ndriçimi i rrugës do të realizohet nga komuna përmes kontratave të tjera që mbulojnë këtë fushë”.

<sup>8</sup> Komuna e Kaçanikut\_Pëgjigje me shkrim\_14.11.2025

# PËRFUNDIME/REKOMANDIME

Në fazën përmbyllëse të projektit, ekipi i Auditimit Social në Kaçanik ka dalë me disa përfundime thelbësore.


## Rekomandimet për përfshirjen e qytetarëve



- Rekomandohet që Komuna t'i implementojë me kohë projektet të cilat financohen nga Granti i Performancës Komunale, sidomos ato që financohen nga MAPL, në mënyrë që mos të rrezikojë humbjen e fondeve. Gjatë monitorimit është vërejtur që te projekti i ndërtimit të hapësirave publike në Kovaçec, Begracë dhe Kaçanik, rëndësi i është kushtuar hapësirave në fshatra ndërsa në qytet punimet ende nuk kanë filluar.
- Komuna duhet të sigurojë përfshirjen e komunitetit nëpërmjet diskutimeve mbi projektet që në fazat e para të planifikimit.
- Ekipi rekomandon që në të ardhmen Komuna e Kaçanikut të publikojë projektet në formë të detajuar, si dhe të bëjë transparente të gjitha dokumentet që lidhen me menaxhimin e kontratës, përfshirë faturat e paguara, punët e kryera, ndryshimet në kontratë dhe arsyetimet për këto ndryshime.
- Komuna duhet t'i zbatojë në plotni rregullat e transparencës në projektet publike të promovuara sipas Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur.



## Rekomandimet për procesin e planifikimit të projektit



- Rekomandohet që në projektet e ardhshme të planifikohet me kohë qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe siç kërkohet me standarde.
- Planifikimet e projekteve të bëhen me kohë në mënyrë që të shmangen vonesat në realizim të projekteve.
- Projektet të diskutohen dhe analizohen mirë në mënyrë për të garantuar qëndrueshmëri afatgjate dhe të shmangët nevoja për intervenime për të sanuar investimet.
- Të evitohen mosplanifikime e keqplanifikime në paramasë dhe parallogari të kontratave. Paramasa të harmonizohet me projektin për të shmangur problemet në implementim.




## Rekomandimet për procesin e mbikëqyrjes së projektit



- Rekomandohet që në projektet e ardhshme, Komuna të vendosë tabela informuese në të gjitha vendpunishtet e projekteve publike, me të dhëna bazë për projektin, afatet dhe palët përgjegjëse, në mënyrë që të rritet transparenca dhe informimi i qytetarëve.
- Është e domosdoshme që mbikëqyrja e punimeve të ushtrohet në mënyrë më aktive, për të parandaluar devijimet nga projekti dhe standardet teknike.
- T'i kushtohet rëndësi cilësisë në realizimin e punimeve.
- Organi mbikëqyrës duhet t'i kushtojë vëmendje të shtuar sinjalistikës për shmangie të rrezikut.
- Organi mbikëqyrës të sugjerojë që kompania punëkryese të tregojë kujdes të shtuar në sigurimin e pajisjeve mbrojtëse për punëtorët, në mënyrë që puna të zhvillohet në përputhje me kërkesat e sigurisë.

## Rekomandimet për investime të reja në projektin e rregullimit të hapësirave në Kovaçec



- Të parashihet qasje e përshtatshme për karroca.
- Të krijohen vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.
- Ulëset dhe pajisjet në park të jenë familjare për persona me aftësi të kufizuara.
- Të parashihen lojëra të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## Rekomandimet për investime të reja në projektin e terreneve sportive në Doganaj - Sopanicë, Duraj



- Të shqyrtohet mundësia e rritjes së rrethojave për të parandaluar daljen e topit dhe për siguri më të madhe.
- Qasje për persona me aftësi të kufizuara në hapësirat e fushës.
- Shtyllat ndriçuese të jenë me dy koka për të mbuluar edhe rrugët përreth, duke rritur sigurinë gjatë natës.
- Nevojitet sistemi për ujitjen e hapësirave të gjelbra brenda terreneve sportive të fushës.
- Rekomandohet mospranimi teknik i punimeve pa u sanuar dëmet në trotualet dhe kubëza.



## METODOLOGJIA

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në muajin korrik, DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në standarde

të paracaktuara përzgjedhi 16 projekte në 6 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social. Në kuadër të procesit të Auditimit Social u përfshinë 16 projekte në 6 komuna.

Emri i projektit	Komuna	Vlera	Faza e projektit në nisjen e auditimit
Asfaltimi i Rrugës Llapushnik-Berishë-Faza e dytë	Drenas	497,724.00 €	Implementim
Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas-Faza e dytë	Drenas	299,652.50 €	Implementim
Rehabilitimi rrugës dhe ndërtimi i trotuarit në Arllat-Negroc-Vuçak	Drenas	700,000.00 €	Tenderim
Instalimi i paneleve solare në kulmin e objekti të Komunës	Drenas	17,812.32 €	Tenderim
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet - Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec	Kaçanik	241,111.11 €	Implementim
Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë Duraj	Kaçanik	260,885.45 €	Implementim
Ndërtimi i trotuareve Brodosanë-Zaplluxhe dhe Brrut-Bellobrad	Dragash	80,299.82 €	implementim
Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Dragash	101,994.69 €	Implementim
Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, Ndriçimi në rrugën unazore në Dragash	Dragash	135,329.28 €	Implementim
Asfaltimi e kubëzimi i rrugëve në fshatrat e Gorës (Restelicë dhe Radeshë)	Dragash	122,219.00 €	Tenderim
Ndërtimi i Shtratit të Lumit Istog dhe Ndërtimi i rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	Istog	Vlera e parashikuar e kontratës është 7,498,356 € (Shtrati i lumit)  301,155 € (rrugët)	Tenderim  Implementim

Gjenerator dhe paisje elektrike për pastrimin e dysHEMEVE-për objektet komunale (administratë, arsim dhe shëndetësi)	Mamushë	52,333.66 €	Tenderim
Muri Gabion në fshatin Gadime e Ulët (te shpella)	Lipjan	59,925.88 €	Implementim
Ndërtimi i shtëpisë muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	Lipjan	121,555.55 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Dobrotinë-Sllovi	Lipjan	267,381.95 €	Implementim
Rikonstruktimi i rrugës Ajet Kozhani Poturovc dhe Ribar i Madh	Lipjan	266,715.00 €	Implementim

## Kush e themeloi grupin e Auditimit Social?

Grupi i Auditimit Social është një grup i qytetarëve të cilët në mënyrë vullnetare i përgjigjen nismës për t'u angazhuar në mbikëqyrjen e projekteve.

Me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të komunitetit, BIRN dhe D+ në bashkëpunim me OJQ-të lokale partnere të projektit, hartuan një listë me profesione dhe përfaqësues të komunitetit, të cilët u ftuan për t'u bashkëngjitur në grup.

Në kriteret e përzgjedhjes u përcaktua se grupi synonte t'u jepte prioritet përfshirjes së kategorive të marginalizuara të shoqërisë siç

janë gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet joshumicë. Synohej që grupi të kishte laramani të profesioneve dhe moshave me qëllim të garantimit të gjithëpërfshirjes.

Ekipet e OJQ-ve partnere të projektit nën fasilitimin e BIRN dhe D+ kontaktuan mbi 200 qytetarë nga 6 komunat për t'i ftuar ata që të bëhen pjesë e grupeve. Mbi 120 qytetarë nga komunat e synuara u bënë pjesë e grupeve.

Në Kaçanik u themelua grupi me mbi 20 qytetarë, të cilët kanë punuar në mbikëqyrjen e projekteve.

## Si u grumbulluan të dhënat?

Për përpilimin e këtij raporti, ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.

Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, ekipi hartoi një listë me pyetje për projektet dhe kërkoi informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizoi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita

në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Kaçanikut.

Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 20 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar nga OJQ Handikos në Kaçanik, me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të BIRN. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Kaçanikut.

## Validimi i të dhënave


Ekipi i Auditimit Social në Kaçanik ka punuar në identifikimin e problemeve në projektet e që janë implementuar në këtë komunë për të shkruar raportin. Në takimet e mbajtura ekipi u dakordua për gjetjet sistematike në dy projektet dhe për gjetjet specifike të projekteve individuale. Ekipi u dakordua

edhe për rekomandimet e paraqitura në këtë raport. Pas strukturimit të gjetjeve ekipi është takuar me kryetarin e komunës dhe ka kërkuar komente nga komuna për gjetjet në raport. Para publikimit komuna ka pranuar raportin për komente eventuale.

## Përbërja e ekipit

Ekipi përbëhet nga **20 anëtarë** të komunitetit me profesione të ndryshme, përfaqësues të të rinjve, gra, burra dhe përfaqësues të personave me aftësi të kufizuara. Kjo përbërje ka siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe përfaqësues të komunitetit lokal me profesione të ndryshme.

Studente; Inxhinier i elektros; Avokat; Zv. Drejtor i SH.M.U. “Emin Duraku” dhe përfaqësues i Klubit të Volejbollit të Vajzave “KV Kaçaniku”; Gazetare; Psikolog/Handikos Kaçanik; Aktivist i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara – Handikos Kaçanik; OJQ “Gjethi”; Përfaqësues i Këshillit të Prindërve; Aktiviste / përfaqësuese OJQ “Stina”; Arkitekt / ndërtues; Mësimdhënës, Klub Futbollit, banor i fshatit Doganaj; Aktivist /OJQ “Gjethi”; Polic; KVRL (Këshilli i Veprimit Rinor Lokal); Mjeke; Banor / përfaqësues i Komitetit për Komunitete; Përfaqësues i Pensionistëve; Përfaqësues i Këshillit të Fshatit; Profesor; Aktiviste;



## Aktivitetet e ekipit të Auditimit Social

Gusht 2025	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Komunën e Kaçanikut</li> <li>● Publikimi i materialeve promovuese në rrjetet sociale</li> </ul>
Shtator 2025	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Trajnimi për OJQ-të lokale, partnere të projektit</li> <li>● Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit</li> <li>● Përgatitja e listës me profilet e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social nga Handikos në Kaçanik</li> <li>● Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social</li> <li>● Dërgimi i kërkesave për qasje në dokumente publike në Komunën e Kaçanikut</li> <li>● Trajnimi i ekipit të Auditimit Social</li> <li>● Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber</li> <li>● Pranimi i përgjigjeve dhe dokumenteve të kërkuara nga Komuna e Kaçanikut</li> <li>● Trajnimi, diskutimi dhe analizimi i dokumenteve të pranuar nga komuna</li> <li>● Vizita në terren e ekipit të Auditimit Social në projektet për monitorim</li> <li>● Takimi i ekipit me Menaxherin e Kontratës të projektit [Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në Lokacionet Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec] Rufat Muqa, dhe Mbikëqyrësin e projektit “Ndërtimi dhe rregullimi i tereneve sportive në bashkësitë lokale Doganaj - Soponicë, Duraj”, Skender Sopa</li> </ul>
Tetor 2025	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Takimi me anëtarët e ekipit për finalizimin e rekomandimeve</li> <li>● Dërgimi i rekomandimeve në Komunën e Kaçanikut</li> <li>● Vizita e radhës në teren e ekipit të Auditimit Social</li> <li>● Takimi me drejtorin e Urbanizmit Qamil Stagova, Menaxherët e Kontratave, Rufat Muqa dhe Valmir Krasniqi</li> <li>● Takimi i ekipit për dakordimin e gjetjeve dhe rekomandimeve finale në draftimin e raportit</li> <li>● Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit</li> <li>● Ndarja e detyrës për shkrimin e raportit për kryesuesin e ekipit të Auditimit Social, Elmihane Malsiu nga OJQ Handikos në Kaçanik</li> <li>● Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social</li> </ul>



## EKIPI I AUDITIMIT SOCIAL NË KAÇANIK

Nr.	Emri / Mbiemri	Profesioni / Funkzioni
1	Aulona Bela	Studente/Inxhiniere e Elektros
2	Shpejtim Vishi	Avokat
3	Lulzim Krasniqi	Zv.Drejtor SH.M.U,“ Emin Duraku” dhe përfaqësues i Klubit të Volejbollit të Vajzave “KV Kaçaniku”
4	Diana Luzha	Gazetare
5	Labinot Guri	Psikolog/Handikos Kaçanik
6	Bashkim Baftiri	Aktivist i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara - Handikos Kaçanik
7	Sami Stagova	OJQ Gjethi
8	Albana Troni Lika	Përfaqësues i Këshillit të Prindërve
9	Zarie Malsiu	Aktiviste/OJQ Stina
10	Izahir Krasniqi	Arkitekt/Ndërtues
11	Nehat Selmanaj	Mësimdhënës, Klubi i Futbollit, Banor i fshatit Doganaj
12	Remzi Reka	Aktivist, OJQ Gjethi
13	Arjeta Bajrami	Polic
14	Ditjona Qaka	KVRL
15	Vjosa Shehu	Mjeke
16	Arben Thaqi	Banor/ përfaqësues i Komitetit për komunitete
17	Hasan Dalloshi	Përfaqësues i Pensionistëve
18	Azem Koraqi	Përfaqësues i Këshillit të Fshatit
19	Selim Reka	Profesor
20	Shefije Baftiri	Aktiviste

# LETRA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT



*Të dashur qytetarë të Komunës së Kaçanikut,*

*Të nderuar bashkëpunëtorë dhe të respektuar miq të projektit “Auditimi Social”. Së bashku ndajmë kënaqësinë dhe përgjegjësinë e Komunës së Kaçanikut, që të realizojmë këtë projekt, të realizuar nga BIRN dhe DEMOS në partneritet me organizatën lokale Handikos Kaçanik. Projekti i Auditimit Social, veç tjerash ka një rëndësi të madhe në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies, elemente me të cilat identifikohet komuna jonë tash e sa vite.*

*Andaj dyert e institucioneve komunale për nisma të tilla do të jenë të hapura gjithmonë. Aq më tepër kur bëhet fjalë për ngritjen e cilësisë në projektet komunale, që kanë për qëllim të mirën e komunitetit. Kjo nismë e Auditimit Social, veç tjerash tregon rëndësinë e angazhimit të një komuniteti të gjerë, për një të mirë të përbashkët. Sepse vetëm duke u angazhuar qytetarët, atëherë mund të arrihet e mira e përbashkët, duke krijuar hapësira për bashkëbisedime, bashkëpunime e mbi të gjitha bashkëqeverisje e qytetarëve me komunën. Në këtë mënyrë po rritet hapësira e bashkëpunimit të qytetarëve me institucionet komunale, duke u krijuar një frymë e re dhe moderne e bashkëpunimit.*

*Transparenca dhe llogaridhënia janë objektivat bazë me të cilën mbështetet puna jonë institucionale, tash e sa vite, andaj edhe ky projekt, ka ndihmuar në rritjen e objektivave komunale, si dhe bashkëqeverisjen me qytetarët tanë. Andaj projekte të tilla do të jenë të mirëseardhura gjithmonë për ne, si dhe do të jemi gjithmonë të gatshëm për bashkëpunime.*

*Në fund dua të shpreh falenderime fillimisht për BIRN, DEMOS dhe HANDIKOS KAÇANIK, si dhe për të gjithë qytetarët e angazhuar në këtë proces, për punën dhe angazhimin e tyre të palodhur.*

*Po ashtu konfirmoj vazhdimin e përkushtimit tonë, për vazhdimin e punëve të mira të komunës, për rritjen e cilësisë në projekte infrastrukturore, e për një komunë kampione në transparencë e llogaridhënie dhe të përgjegjshme ndaj secilit qytetar.*

## LETRA E EKIPIT TË AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

*Procesi i Auditimit Social në Komunën e Kaçanikut ishte një përvojë e re, e cila na mundësoi të kuptojmë më thellë rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në monitorimin e projekteve publike. Në fillim, kjo iniciativë ishte diçka e panjohur për shumicën prej nesh, por pas trajnimit të organizuar nga BIRN Kosova dhe me mbështetjen e Handikos Kaçanik, u bë e qartë se Auditimi Social është një mjet i fuqishëm për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.*

*Gjatë këtij procesi kemi monitoruar dy projekte të rëndësishme komunale:*

- *Ndërtimin dhe rregullimin e terreneve sportive në Doganaj–Soponicë, dhe*
- *Ndërtimin dhe rregullimin e hapësirave publike në Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec.*

*Përmes vizitave në terren, takimeve me zyrtarët komunalë, menaxherët e projekteve dhe banorët e zonave përkatëse, kemi identifikuar një sërë gjetjesh që lidhen me sigurinë, qasjen universale dhe funksionalitetin e hapësirave publike. Si rezultat i këtij angazhimi, janë dërguar rekomandime konkrete për përmirësim, si: sigurimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara, vendosja e sinjalistikës mbrojtëse, përmirësimi i infrastrukturës për fëmijë dhe garantimi i kushteve të sigurisë në vendpunishte.*

*Në rastin e projektit në Kovaçec, grupi ka propozuar rishikimin e konceptit të projektit për ta bërë hapësirën më funksionale dhe më të sigurtë për komunitetin, duke kërkuar që një pjesë e paraparë për parking të shndërrohet në kënd lodrash për fëmijë, ndërsa zona e tretë të shfrytëzohet si hapësirë relaksuese për banorët. Këto ndryshime synojnë krijimin e një ambienti gjithëpërfshirës dhe të sigurtë për të gjithë qytetarët.*

*Përvoja me Auditimin Social ka treguar se kur qytetarët angazhohen dhe zëri i tyre dëgjohet, projektet publike bëhen më të qëndrueshme, më transparente dhe më të dobishme për komunitetin. Ne si grup jemi krenarë që përmes këtij procesi kemi kontribuar në përmirësimin e cilësisë së projekteve dhe në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunës, organizatave partnere dhe qytetarëve.*

*Besojmë se Auditimi Social duhet të vazhdojë si praktikë e mirë për të gjitha komunat në Kosovë, sepse ai i afron institucionet me qytetarët dhe e kthen përgjegjësinë publike në një proces të hapur, të drejtë dhe gjithëpërfshirës.*



Co-funded by  
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige